

VENDIM
Nr. 494, datë 1.7.2016

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 407, DATË 8.5.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E NJË REGJIMI KONTROLLI PËR TË GARANTUAR RESPEKTIMIN E
RREGULLAVE TË POLITIKAVE MENAXHUESE NË PESHKIM”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 72, pika 8, 74, pika 4, 77, pika 3, 82, pika 2, 101, pika 2, 112, pika 3, 113, pika 1, 116, 118, pika 3, e 135, pika 1, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 30, të vendimit nr. 407, datë 8.5.2013, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 30.1, 30.2, 30.3, 30.4, 30.5, 30.6, 30.7, me këtë përmbajtje:

“30.1 QNOD-ja nëpërmjet SVA-së regjistron datën dhe orën e hyrjes e të daljes së anijeve të peshkimit nga dhe në zonat e mëposhtme:

- a) të gjitha zonat sipas nenit 11, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”;
- b) të gjitha zonat sipas nenit 104, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”;
- c) të gjitha zonat që rregullohen nga organizatat rajonale të peshkimit, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë;
- ç) në ujërat nën sovranitetin e një shteti tjetër.

30.2 Në rast se pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, e instaluar në bordin e anijes, pëson defekt ose nuk funksionon gjatë lundrimit, kapiteni ose përfaqësuesi i anijes, duke filluar nga momenti kur është verifikuar defekti ose nga momenti i informimit sipas pikës 35, njofton çdo dy orë në QNOD për koordi-natat gjeografike të azhurnuara të anijes me SMS ose nëpërmjet faksit apo komunikimit me radio.

30.3 QNOD-ja hedh në sistem menjëherë koordinatat gjeografike sipas pikës 32 në bankën e të dhënave të SVA-së. Të dhënat e hedhura në mënyrë manuale në bazën e të dhënave duhet të jenë lehtësisht të dallueshme nga mesazhet auto-matike të sistemit.

30.4 Në rastin kur pajisja për lokalizimin nga sateliti ka defekt teknik ose nuk funksionon, anija e peshkimit nuk mund të largohet nga porti deri në momentin kur ministria ose enti i caktuar prej saj të certifikojë që kjo pajisje e instaluar në bor-din e anijes funksionon perfekt. Si përjashtim nga ky rregull, QNOD-ja mund të autorizojë anijet e peshkimit të lënë portin e peshkimit me një pajisje për lokalizimin nga sateliti jofunk-sionale, me qëllim riparimin ose zëvendësimin e saj.

30.5 Në rast se pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, e instaluar në bordin e anijes, rezulton jo plotësisht funksio-nale, QNOD-ja njofton menjëherë kapitenin e anijes ose përfaqësuesin e saj. Heqja e pajisjes për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit me qëllim riparimin e saj bëhet vetëm me miratimin e ministrisë.

30.6 Nëse për gjashtë orë rresht QNOD-ja nuk merr të dhënat sipas pikës 24, ajo informon menjëherë kapitenin ose përdoruesin e anijes së peshkimit apo përfaqësuesin e saj. Nëse për të njëjtën anije peshkimi ky fakt përsëritet me shumë se tri herë brenda vitit, ministria ose enti i caktuar prej saj kontrollojnë me imtësi pajisjen për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit, duke verifikuar gjithashtu nëse është ndërhyrë në këtë pajisje. Për këtë qëllim, si përjashtim nga përcaktimi i pikës 28, pajisja për identifikimin dhe lokalizimin nëpërmjet satelitit mund të çmontohet për t’u ekzaminua.

30.7 Nëse për gjashtë orë rresht QNOD-ja nuk merr të dhënat sipas pikës 24 dhe anija e peshkimit në komunikimin e fundit ka qenë në ujërat e një shteti tjetër, QNOD-ja njofton

shtetin tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur në lidhje me këtë çështje.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama